




# BULETINI

Gusht 2014, nr. 8

Përmbajtja:

Aktivitetet nga Programi  
i Trajnimit Fillestar  
(PTF)

Aktivitetet tjera



## Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)

### Trajnim i kandidatëve të PTF në Administratën Tatimore të Kosovës



Më 07 gusht 2014, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës realizoi trajnimin praktik me kandidatët e gjeneratës së pestë të Programit të Trajnimit Fillestar (PTF).

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të cilët ndjekin trajnimet në PTF, t'iu ofrohet njohuri për punën dhe aktivitetet që kryen Administrata Tatimore e Kosovës, me ç' rast njohuritë e marra nga ky institucion do të ju shërbejnë në të ardhmen gjatë praktikës në përmirësimin e kualitetit të punës dhe ngritjes së bashkëpunimit në mes gjyqtarëve dhe prokurorëve

në njërën anë dhe Administratës Tatimore të Kosovës në anën tjetër.

Çështjet që u debatuan gjatë trajnimit ishin roli, përgjegjësitë dhe baza ligjore e ATK-së, normat tatimore, përmbushja e detyrimeve tatimore, tatimet e aplikuara në Kosove, detyrimi për regjistrim dhe pajisja me numër fiskal, detyrimet për deklarim dhe pagesë të tatimeve, ndëshkimet administrative tatimore, e drejta e ankesës dhe procedurat shqyrtuese.

Ky trajnim u zhvillua në formë të bashkëbisedimit dhe pas prezantimeve kandidatët trajtuan raste nga praktika e ATK.

Pjesëmarrës në trajnim ishin 18 kandidatët për gjyqtarë dhe 10 kandidatë për prokurorë.



## Aktivitetet e realizuara në PTF gjatë periudhës 11-15 gusht 2014



Me 11 deri 15 gusht, IGJK ka realizuar trajnimet në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar sipas programit dhe kalendarit trajnues.

Me 11 gusht 2014, kandidatët për gjyqtarë kanë ndjekur trajnimet në modulën e Procedurës Përmbartimore, me temë: “Kompetenca e organit përmbartues dhe shqyrtimi i propozimit përmbartimor” si dhe në modulën Procedurës Jokontestimore, gjegjësisht në temën “Dispozitat e përgjithshme të ligjit të Procedurës Jokontestimore”. Ndërsa kandidatët për prokurorë kanë ndjekur trajnimet në modulën - Shmangia nga ndjekja penale dhe modulën: Aktakuza, procedura e shqyrtimit” me fokus në temën: “Ngritja e aktakuzës”.

Me 12 gusht 2014, kandidatët për gjyqtarë kanë vijuar me trajnimet në modulën - E drejta e Trashëgimisë, me temë “Trashëgimia me ligj, trashëgimia e domosdoshme dhe transaksionet ndërmjet të gjallëve”, kurse kandidatët për prokurorë kanë ndjekur trajnimin në modulën - Aktakuza, procedura e shqyrtimit, me temë “Të drejtat e të pandehurit pas pranimit të aktakuzës”. Gjatë kësaj dite, kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, së bashku, kanë vijuar edhe trajnimin në modulën: Procedurat e veçanta sipas KPPK, me temë: “ Procedura ndaj personave të cilët kanë kryer vepër penale nën ndikimin e alkoolit ose drogës dhe procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore”.

Me 14 gusht 2014, po ashtu është realizuar trajnimi i përbashkët për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë për “Platformën e - learning”.

Me 15 gusht 2014, kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë kanë ndjekur trajnimin në dy module të përbashkëta: Krimi kibernetik, dhe Administrimi i procedurës penale, me temën “Dërgimi i shkresave, ekzekutimi i vendimeve si dhe dispozitat tjera”.

Trajnimet janë zhvilluar sipas metodologjisë bashkëkohore, duke i kombinuar shpjegimet teorike me raste praktike, përmes rasteve për studim dhe ndarjes së kandidatëve në grupe.

## Trajnimi i kandidatëve të PTF në platformën E-learning Moduli “Teknologjia informative”



Më 14 gusht 2014, IGJK ka realizuar trajnimin për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë lidhur me platformën e mësimit në distancë (e-learning).

Synime kryesore të këtij trajnimi ishin; njohja me platformën e mësimit në distancë - mënyra e funksionimit dhe zbatimit të saj në praktikë si dhe realizimi i modulit për teknologji informative në kuadër të kësaj platforme.

Paraprakisht, kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë janë regjistruar në këtë platformë, në mënyrë që gjatë realizimit të trajnimit të kenë mundësinë e demonstrimit praktik.

Kandidatët patën mundësinë që përmes prezantimeve të shkurtra dhe veprimeve praktike të njoftohen me mënyrën e qasjes në kurset trajnuese, gjetjen e materialeve për kurset përkatëse, komunikimin përmes forumit dhe mundësitë tjera që ofron platforma e mësimit në distancë.

Për më tepër, gjatë elaborimit të modulit për teknologjinë informative fokusi ishte në përdorimin e programeve të Office siç janë: Word, Outlook dhe PowerPoint.

Përfitues të këtij trajnimi ishin kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë të Programit të Trajnimit Fillestar të gjeneratës së pestë.



## Aktivitetet e realizuara në PTF gjatë periudhës 18-22 gusht 2014

Me 18, 19 dhe 22 gusht, IGJK ka realizuar trajnimet e parapara sipas orarit trajnues të Programit të Trajnimit Fillestar.

Me 18 gusht 2014, kandidatët për gjyqtarë kanë ndjekur trajnimet në modulën e Procedurës Përmbaremore, me temë: “Titujt ekzekutiv dhe përmbaremi përmes xhirollogarive bankare ” si dhe në modulën e Procedurës Jokontestimore, në temën “Shpallja e zhdukjes së një personi, procedura e shpalljes së personit të zhdukur si i vdekur dhe procedura e të provuarit të vdekjes”. Po me këtë datë kandidatët për prokurorë kanë ndjekur trajnimet në modulën - Shmangia nga Ndjekja Penale me temë “Pezullimi i hetimit sipas KPPK-së” dhe në modulën: Procesverbalet, me fokus në temën: “Procesverbalet e prokurorisë”.

Me 19 gusht 2014, kandidatët për gjyqtarë kanë ndjekur trajnimin në modulën - E Drejta e Trashëgimisë, me temë “Kompetencat e gjykatave në shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, ndarja e trashëgimisë dhe ndarja me testament”, ndërsa kandidatët për prokurorë kanë ndjekur trajnimin në modulën - Aktakuza, procedura e shqyrtimit, me temë “Ndryshimi, zgjerimi dhe hudhja e aktakuzës”.

Gjatë pasdites së datës 19 gusht, kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, së bashku, kanë vijuar trajnimin në modulën: Kontrolli dhe Konfiskimi, me temë: “Konfiskimi-ndalimi para ngritjes së aktakuzës”.

Me 22 gusht 2014, kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë kanë ndjekur trajnimin në dy module të përbashkëta - Ngritja e shkathtësive sociale të gjyqtarëve e prokurorëve, konkretisht tema “Komunikimi dhe interaksioni social” dhe në modulën - Krimi Kibernetik.

Trajnimet janë zhvilluar sipas metodologjisë bashkëkohore, duke i kombinuar shpjegimet teorike me raste praktike, përmes studimit të rasteve dhe ndarjes në grupe të kandidatëve.



## Aktivitetet e realizuara në PTF gjatë periudhës 25 – 29 gusht

Me 25 deri 29 gusht, IGJK ka realizuar trajnimet për kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë (gjenerata e V-të) në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, me ç’rast edhe ka përfunduar faza e dytë e këtij programi.

Me 25 gusht 2014, kandidatët për gjyqtarë kanë ndjekur trajnimet në modulën e Procedurës Përmbartimore, me temë: “Mjetet juridike në Procedurën Përmbartimore dhe kthimi i punëtorit në punë” si dhe modulën - Procedura Jokontestimore, me temë “Caktimi i lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar, rregullimi i megjës dhe ndarja fizike”. Ndërsa, kandidatët për prokurorë kanë ndjekur trajnimet në modulën - Shmangia nga ndjekja penale me temë “Pushimi i hetimit sipas KPPK-së” dhe në modulën: Procesverbalet, me fokus në temën: “Procesverbalet e Shqyrtimit Gjyqësor”.

Me 26 gusht 2014, kandidatët për gjyqtarë kanë ndjekur trajnimin në modulën - Kundërvajtje, me temë “Vepra e kundërvajtjes, procedura e kundërvajtjes dhe aktvendimi mbi kundërvajtjet”, ndërsa kandidatët për prokurorë kanë vijuar trajnimin në modulën - Aktakuza, procedura e shqyrtimit, me temë “Propozimet ndaj kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore dhe ndaj të miturve”. Gjatë pasdites së datës 26 gusht, kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, së bashku, kanë vijuar trajnimin në modulën: Kontrolli dhe Konfiskimi, me temë: “Procedura për konfiskim pas ngritjes së aktakuzës”.

Me 29 gusht 2014, kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë kanë ndjekur trajnimin në dy module të përbashkëta - Ngritja e shkathtësive sociale të gjyqtarëve e prokurorëve, konkretisht tema “Personaliteti si dhe ngritja e shkathtësive sociale predispozite e avancimit të performances profesionale” dhe në modulën - Shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike.

Trajnimet janë zhvilluar sipas metodologjisë bashkëkohore, duke i kombinuar shpjegimet teorike me raste praktike, përmes rasteve për studim dhe ndarjes së kandidatëve në grupe.



## Aktivitetet tjera

### Udhëheqësia e Qëndrueshme



Me 26 gusht 2014, IGJK në bashkëpunim me EROL – USAID, ka realizuar trajnimin me temë “Udhëheqësia e Qëndrueshme”.

Synime kryesore të këtij trajnimi ishin: dimensionet e mirëqenies që janë të nevojshme për një sistem gjyqësor të qëndrueshëm, metodat për identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe zhvillimin e proceseve mbrojtëse përfshirë teknikat e menaxhimit të stresit, metodat për

zhvillimin e faktorëve mbrojtës, identifikimin e rrezikut përmes përdorimit të një liste për mirëqenie si dhe zhvillimin e një plani personal për mirëqenien dhe për të kuptuar psikologjinë e qëndrueshme të ndryshimit të sjelljes.

Përmes përdorimit të metodave të mësimit për të rritur, u trajtuan dimensionet e mirëqenies me fokus në të ashtuquajturin “Qarku i Mirëqenies” që përfshinë mirëqenien mendore, emocionale, fizike, shpirtërore, marrëdhëniet me të tjerët si dhe mjedisin ku jetojmë dhe punojmë. Ndër temat tjera të trajtuara ishin edhe simptomat dhe trajtimi praktik i stresit, zhvillimi i qëndrueshmërisë, përfshirë hartimin e një plani personal të mirëqenies nga ana e përfituesve i cili fokusohet në qëllimin personal të mirëqenies, hapat afatshkurtra të veprimit, identifikimin e pengesave dhe qasjes ndaj tyre.

Përfitues të trajnimit ishin stafi i IGJK-së.



# BULETINI



Si të na gjeni:  
Nëse keni nevojë për  
më shumë informacion  
ju lutem na kontaktoni  
në :

**Instituti Gjyqësor i  
Kosoves**

Rr. "Muharrem Fejza"  
p.n. Prishtinë

Tel:  
+381 38 200 18 679  
+381 38 200 18 660  
+381 38 200 18 667  
infokji@rks-gov.net  
<http://igjk.rks-gov.net>